



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	SP-02	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	7022-2/26
Nr. i fletëve Broj. stranica No. pages	03	Data Datum Date	21.09.2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	15.09.2026
REFERENC-Ë:	25/7022/MMPH
PËR/ZA/TO:	"HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj, Stacion i karburanteve në Llaplasellë, Graçanicë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për aprovim të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve me Nr. Prot. 25/7022/MMPH.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve Ferizaj, për veprimtarinë: Stacion i karburanteve në Llaplasellë, Graçanicë; dhe
- Shtojcën: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/7022/MMPH


Datë: 15.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 12 paragrafi 1, 5 dhe 7 dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore si dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.14/5440/1-ZSP/18/15, datë: 28.01.2015, dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore të dt. 24.08.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve- Ferizaj, pajiset me Leje Mjedisore për stacionin e karburanteve, me kapacitet të rezervuarëve: V= 29990, 29988, 25110 dhe 29921 litra naftë dhe benzinë si dhe 15.000 litra GLN, në ngastrat kadastrale me nr. P-73414042-01888-4, nr. P-73414042-01888-12, në Llapllasellë- Graçanicë
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të kontrollohet dhe mirëmbahet separatori i vajrave dhe lubrifikanteve;
 - 2.3. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH;
 - 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;

Faqe 2 nga 3



2.5. Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të bëjë rehabilitimin e zonës së ndikuar.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe debatit publik për operatorin "HIB Petrol" Sh.p.k Talinoc i Muhaxherëve- Ferizaj, është konstatuar se Operatori për stacionin e karburanteve, me kapacitet të rezervuarëve: V= 29990, 29988, 25110 dhe 29921 litra naftë dhe benzinë si dhe 15.000 litra GLN, në ngastrat kadastrale me nr. P-73414042-01888-4, nr. P-73414042-01888-12, në Llapllasellë- Graçanicë, plotëson kriteret e parapara me Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr.04/2022 për Leje Mjedisore dhe Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

UD Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së